

# Fjala përshëndetëse në konferencën e 110-vjetorit të Normales, “Përtej mitit”

---

Valter Memishaj

Drejtor i Institutit të Gjuhësisë dhe të Letërsisë  
Akademia e Studimeve Albanologjike

Tiranë

Të nderuar të pranishëm,

Më lejoni, që në emër të gjithë punonjësve shkencorë të Akademisë së Studimeve Albanologjike, Tiranë, si dhe në emrin personal të drejtorit të saj Akademik Marenglen Verli, të përshëndes këtë veprimtari me rëndësi të shënuar, organizuar me rastin e 110-vjetorit të Shkollës Normale, si dhe të Kongresit të Elbasanit.

Ky kongres me karakter mbarëshqiptar, që i zhvilloi punimet vetëm 10 muaj pas Kongresit të Manastirit (2-8 shtator 1909), me pjesëmarrjen e 35 përfaqësuesve të klubeve dhe shoqërive shqiptare, mori vendime të rëndësishme për përhapjen e shkollave shqipe (ndaj dhe quhet ndryshe Kongresi i Shkollave Shqipe), si dhe për probleme të tjera të lëvizjes kombëtare.

Nuk ishte e rastësishme që për mbajtjen e tij u zgjodh qyteti i Elbasanit. Ky qytet, i njerëzve të qetë e të mençur, punëtorë e arsimdashës, shenjohej si një nga qytetet me tradita të shkëlqyera patriotike, arsimore e kulturore dhe me figura të spikatura të Rilindjes Kombëtare e të luftës për pavarësimin e vendit.

Kongresi vendosi që të themelohej në Elbasan një shkollë e mesme pedagogjike shqipe, e quajtur ndryshe “Shkollë Normale”, që do të përgatiste mësues për

shkollat fillore shqipe për gjithë hapësirën kombëtare dhe që do të mbahej me kontributin e të gjitha klubeve e të shoqërive shqiptare.

Për të ndihmuar në themelimin e mbarëvajtjen e kësaj shkollë, por edhe për përhapjen e shkollave shqipe në mbarë vendin e me synimin që ato të punonin në bazë të një programi të vetëm e të përbashkët, si dhe për botimin e librave shqip, në Kongres u diskutuan edhe disa çështje organizative dhe politike. Për të forcuar bashkëpunimin, lidhjet organizative dhe bashkërendimin e veprimeve ndërmjet të gjitha klubeve e shoqërive, u vendos që të gjitha klubet e shoqëritë shqiptare të drejtoheshin nga një klub qendror me emrin kuptimplotë “Përparimi”. Ky klub do t’u jepte ndihmë shkollave shqipe ekzistuese, do të orientonte çeljen e shkollave të reja në shumë vise të vendit, si dhe do të punonte për futjen e mësimin shqip në të gjitha shkollat e huaja që ekzistonin.

Kongresi mori në shqyrtim edhe problemin e gjuhës së shkruar dhe pjesëmarrësit kërkuar një shqipe të vetme letrare, si dhe normalizimin e ortografisë. Delegatët kërkuar gjithashtu që për krijimin e këtij varianti të merrej për bazë e folmja e Elbasanit, e cila ishte e kuptueshme nga të gjithë shqiptarët.

Edhe pse M. Frashëri, theksonte se *“Kongresi ynë është thjesht gjuhësor dhe se ne nuk merremi me politikë. Edukim, shkolla, këto janë dy nenet e vetme të programit të seancave tonë”*, në seancat e Kongresit u diskutua dhe qëndrimi që duhej mbajtur dhe ndaj politikës së xhonturqve, që u mohonte popujve joturq çdo të drejtë kombëtare, e për pasojë shkrimin e gjuhës sonë amtare e përhapjen e shkollave shqipe.

Dihet tashmë se vendimet e Kongresit të Elbasanit i dhanë një hov të mëtejshëm lëvizjes kombëtare dhe ato kështu përbëjnë vlerë dhe kontribut në drejtim të përhapjes së arsimit, gjuhës amtare e kulturës kombëtare.

Të nderuar të pranishëm, vetëm pak kohë pas mbylljes së punimeve të Kongresit, u bë realitet hapja e Shkollës Normale, e cila feston sot 110-vjetorin e hapjes së dyerve. Vështruar nga kjo rrugë mbi njëshekullore theksojmë se ajo nuk ka qenë e nuk është thjesht një shkollë, ajo është institucion, ajo është emblemë në rrugëtimin e arsimit tonë kombëtar, ajo ishte dhe mbetet vatra kryesore e përgatitjes së mijëra mësuesve që dhanë ndihmesën e vet në hapësirat kombëtare shqipfolëse. Ajo është prijatë dhe e tillë duhet të mbetet. Sot misionin e përgatitjes së mësuesve e kryen Universiteti “Aleksandër Xhuvani”, që është vazhdim i denjë i Shkollës Normale, por i një hapësire tjetër më të lartë shkencore e më të plotë arsimuese.

Akademia e Studimeve Albanologjike, me këtë rast duke u mbështetur dhe në marrëveshjen e lidhur më këtë universitet, pohon se do të japë ndihmesën e vet për gjithçka është e nevojshme dhe e domosdoshme në fushat e përbashkëta e sidomos në ato të kërkimit shkencor, për të kontribuar në lartimin e emrit dhe në ngritjen e prestigjit të Universiteti “Aleksandër Xhuvani” dhe të vetë Elbasanit, kërthizës së qytetarisë e të arsimit mbarëkombëtar.

Ju faleminderit!